



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEQA"

# METODAT E HULUMTIMIT KUANTITATIV

## HULUMTIMET KUANTITATIVE DHE ZHVILLIMI I PYETJES HULUMTUESE

Java 2

*Ph.D. Fisnik Morina*



SHKURT, 2018



# METODAT E HULUMTIMIT KUANTITATIV

2

- Lënda: Metodatat e hulumtimit kuantitativ
- Viti I-rë, Semestri II, Departamenti: MBNJ
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (3 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Mësimdhënes: Prof. Asoc. Dr. Florin Peci  
Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: [florin.peci@unhz.eu](mailto:florin.peci@unhz.eu)  
[fisnik.morina@unhz.eu](mailto:fisnik.morina@unhz.eu)

# Objektivat mësimore:

3

- Çka është hulumtimi;
- Zhvillimi efektiv i pyetjes hulumtuese;
- Problemi hulumtues dhe objektivat/hipotezat
- Organizimi e hulumtimit ekonometrik në tezën e mastrit.

# Çka është hulumtimi

4

- Hulumtimi = krijimi i njohurive të reja në shkencën ekonomike
- Si të krijojmë këto njohuri
  - ▣ Krijo ose dizajno një **argument**
  - ▣ Argumenti patjetër të parashtrohet si **problem** pastaj si **pyetje**
  - ▣ Argumenti patjetër të mbështetet nga **evidenca empirike**

# Zhvillimi efektiv të pyetjes hulumtuese

5

## Kater pyetjeve patjetër t'ju japim përgjegje:

1. Cfarë është teza ose tema e hulumtimit
  1. **Fusha gjenerale** (inflacioni, papunsia, sjellja konsumatore, varfëria)
2. Cfarë është problemi, ku si rrjedhim parashtrohet pyetja hulumtuese;
  1. **Problem:** (norma të larta të interesit pengojnë rritjen ekonomike) dhe
  2. Cfarë është pyetja hulumtuese (Qëllimi)
    - **Një fjali për pyetjen hulumtuese**
      - *Shembull: Qëllimi kryesor i tezës së magistraturës është të matim raportin në mes normës së interesit dhe rritjes ekonomike në Kosovë.*
      - *Andaj parashtrohet pyetja nëse zvoglohen normat e interesit a do të kemi rritje ekonomike?*
3. Cfarë është hipoteza hulumtuese (**Objektivi/Hipoteza**)
  - **Propozimi i përgjegjes së pyetjes hulumtuese të parashtruar;**
    - **Shembull: H1/1: Ulja e normës së interesit do të shkaktojë rritje ekonomike**
4. Metodat hulumtuese që do të përdoren për konfirmimin ose hüdhen e hipotezave.

# Zhvillimi efektiv i pyetjes ose problemit hulumtues:

## Si fillon

6

- Zgjedh tezën e mastrit;
  - Journal of Economic Literature Classification
    - [http://www.aeaweb.org/journal/jel\\_class\\_system.html](http://www.aeaweb.org/journal/jel_class_system.html)
- Fillon në leximin e literaturës dhe vështrimin kritik të saj;
  - Cfarë është **bërë**
  - Cfarë pyetje është e **hapur ose e pa zgjedhur**
  - A ka **kontradikta** në literaturë
- *Përkufizon problemin dhe zgjedh pyetjen hulumtuese nga shprastira në literaturë dhe pastaj formulohet objektivi/hipoteza;*
- **Hipoteza:** përgjegje e pyetjes hulumtuese të parashtruar.
- **Metodat hulumtuese** që do të përdoren për konfirmimin ose hüdhen e hipotezave.

# Zhvillimi efektiv i pyetjes hulumtuese – Si te gjendet zbrastësia në literaturë

7

- Hyrje në tezen e mastrit
  - ▣ Në secilen tezë duhet të **identifikohet problemi dhe te parashtrahet pyetja hulumtuese** dhe si ajo ndryshon nga hulumtimet tjera në hyrje
- Konkluzioni i tezës së mastrit
  - ▣ Secila tezë duhet të paraqes **dobsitë** e saja dhe studimi i **metutjeshem i tezës** në fjale në konkluzion.

# Komponentat e procesit hulumtues

8

Pas zgjedhjes së tezës, figura me poshte tregon komponentet e procesit te hulumtimit dhe lidhjet mes tyre.





# Problemi i hulumtimit

- **Problemi i hulumtimit**— diferenca mes asaj qe **njihet** dhe asaj qe **duhet te njihet**. Nje problem kerkimi shpreh nevojen ose deshiren per te njohur ose kuptuar dicka.
- Diferenca mes asaj qe njihet dhe asaj qe duhet te njihet mund te bjere ne kerkimin **disiplinar**, kerkimin mbi **subjektin** apo ne kerkimin per **zgjidhjen** e problemit.

# Problemi i hulumtimit

10

- Kjo eshte **pjesa me e rendesishme** dhe me kritike e cdo projekt hulumtimi.
- Problemi eshte fokusi si i hulumtimit baze ashtu edhe atij te zbatuar. Ne fakt, problemi eshte **arsyeja** (justifikimi) per hulumtim.
- **Identifikimi dhe shpjegimi** i problemit **ndikon** gjithe cilesine, dobine, efektivitetin, dhe eficencen e kerkimit, me shume se cdo pjese tjeter e planit te hulumtimit.

# Problemi i hulumtimit

11

## Çështjet

- ▣ Situata problematike: problemi i pergjitheshem
- ▣ Problemi i hulumtueshëm
- ▣ Justifikimi
- ▣ Hipotezat dhe objektivat

# Problemi i hulumtimit...

12

- Problemi i përgjithshëm (situata problematike)  
Nje **fushe e gjere** problemi qe permban nje numer problemesh. Ajo jep **sfondin** për problemin e kërkimit.
- Problemi specifik (problemi i hulumtueshëm)  
**Ngushton** perspektivën e një problemi në një numër **çështjesh** mbi të cilat ka nevojë për njohuri të reja.
- Justifikimi. Një formulim problemi duhet të
  - Drejtojë lexuesit të pranojë objektivat (**cfare dije nevojitet**) që duhen arritur pra të bindë lexuesin se “...natyrisht, kjo është ajo që duhet.”
  - Tregojë se **kujt i nevojitet kjo dije** dhe
  - Permende **sukseset dhe dështimet** e përpjekjeve të mëparshme për të zgjidhur problemin.

# Situata problematike...

13

- Një situatë problematike është një fenomen që **ekziston**
- Një situatë problematike përfaqëson një situatë të **përgjithshme**  
**Shembull: deficitin e bilancit tregtar, jo eficientia në shfrytëzimin e resurseve, papunsia, rritja e ulët ekonomike;**
- Një situatë problematike mund të jetë **burim për një numër problemesh hulumtimi**. Kërkesat të ndryshme do të arrijnë në formulimin e një numri problemesh nisur nga e njëjta situatë problematike.

# Situata problematike...

14

- Formulimi i **problemit te pergjitheshem jep sfondin** per problemin e hulumtueshëm.
- Zakonisht, ai ndihmon te prezantohet problemi fillimisht me fraza te pergjitheshme, pastaj te **ngushtohet fokusi progresivisht** ne nje ceshtje me te sakte, me specifike.
- *Kjo do te thote se formulimi i problemit duhet te behet duke patur parasysh **audiencen e pritur**.*

# Problemi i hulumtueshem

15

1. Problemi i hulumtimit reflekton një **nevojë** të ndjerë
  - ▣ Kjo do të thotë thjesht se problemi i kërkimit duhet të **gjendet në një fushë situate problematike**, p.sh. Investimet e ulta, norma të larta të interesit, rritje e ulët ekonomike etj.
- 
2. Problemi i hulumtimit duhet të bazohet në **fakte** dhe rishikimin e literatures
  - ▣ Problemi i kërkimit nuk është **hipotetik**. Problemi i kërkimit duhet të bazohet në **fakte** dhe në rishikimin e literatures
3. Problemi i hulumtimit duhet të sugjerojë **hipoteza logjike** dhe të testueshme
  - ▣ *Hipotezat formulohet si shpjegime të pjeshme të **lidhjeve të panjohura që shkaktjnë problemin**. Hipotezat janë të vlefshme kur informacioni mbi vlefshmërinë e tyre mund të mblidhet dhe analizohet.*

# Problemi i hulumtueshem

16

4. Problemi i hulumtimit duhet të sugjerojë **hipoteza logjike dhe të testueshme**
  - ▣ Hipotezat duhet të tilla që testimi i tyre të mos rezultojë në zgjidhje pa vlerë, por me vlere p.sh.,
  - ▣ H1/1: “ **Rritja e investimeve të huaja do të ndikojë në rritjen ekonomike**”
  - ▣ Nëse formulimi i problemit nuk sugjeron hipoteza të testueshme për zgjidhjen e problemit të hulumtimit, kërkuesi nuk ka formuluar në mënyrë të përshtatshme problemin e hulumtimit.



# Problemi i hulumtueshëm...


## Burimet e disponueshme

17

Problemi specifik do të thote se problemi i kerkueshem duhet te jete **i specifikuar ne menyre te sakte** dhe i tille qe te mund te adresohet me **burimet e disponueshme**.


Adresimi i nje problemi te kerkueshem do te thote nje **pergjigje e pjesseshme** per situaten problematike.

A kenaqemi ne me **dijen e pjesseshme** mbi nje situate problematike?



# Problemi i kerkueshem

18



# Hipotezat dhe objektivat

19

- Nepermjet hipotezave/objektivave, përcaktohet se **çfarë** planifikohet të arrihet përmes kërkimit; **kufizohet** puna e kërkimit; mund të **identifikohet klientela** e kërkimit
- Përderisa **hipotezat janë shumë të rëndësishme** do merremi fillimisht me hipotezat
- Hipotezat dhe objektivat - dallimet
  - Hipotezat duhet të **bazohen** ne objektiva ose anasjelltas.
  - Hipotezat duhet të jenë të **testueshme**.
  - Hipotezat mund të formulohen **krahas me ose në vend** të objektivave.
  - Objektivat janë zakonisht **më të lehta** për tu kuptuar nga njerëzit e zakonshëm; hipotezat mund të jenë më të sakta. **Perdoren ne mjedise akademike**

# Hipotezat dhe objektivat

20

Të shmangen hipotezat, nëse:

1. Fenomeni **nuk ekziston** në formën e hipotezuar;
2. **Informacioni** mbi atë çka observohet **nuk** mund të **matet** ose nese te dhenat jane te pamjaftueshme
3. Testimi i i hipotezave do të kërkojë **më shumë burime** se ç'janë disponibël;
4. Hipotezat nuk janë të përshtashme ose jane te **parëndësishme**.

# Hipotezat dhe objektivat

## Shembull problemi dhe hipotezat

21

### Problemi:

- ▣ Faktorët që ndikojnë në rritjen ekonomike mbeten **pamjaftueshmërisht të njohur**. **Përmirsimi i kuptueshmërisë** mbi këta faktorë do të përmirsonte politikat e mbështetjes publike dhe aktorëve tjerë të interesuar.

### Hipotezat:

- ▣ *Rritja e liberalizimit të tregut do të ndikonte **pozitivisht** në rritjen ekonomike.*
- ▣ *Rritja e investimeve të huaja do të ndikonte **pozitivisht** në rritjen ekonomike.*
- ▣ *Rritja e investimeve të kapitalit do të ndikonte **pozitivisht** në rritjen ekonomike.*
- ▣ *Ulja e indeksit të korrupsionit do të ndikonte **pozitivisht** në rritjen ekonomike.*

# Hipotezat dhe objektivat

## Udhëzime lidhur me objektivat

23

- Çdo objektiv i “vërtetë” është i **përkthyeshem** në hipotezë;
- Një rrugë për të kuptuar nëse një “objektiv” është **vërtet** një objektiv dhe jo një procedurë është që ai (objektivi) të kalojë testin “Nëse ... atëherë”
- Një praktikë e zakonshme është formulimi i një **objektivi të përgjithshëm** dhe i disa objektivave **specifikë**. Këta të fundit mund të konvertohen në hipoteza
- Shmangni **përzierjen** e objektivave me metodat (procedurat).  
Një objektiv specifik është ajo që është e nevojshme për arritjen e objektivit të përgjithshëm, ose për zgjidhjen e problemit. **Një metodë është një teknikë se si do të arrihet një objektiv.**

# Hipotezat dhe objektivat

## Formulimi i objektivave

24

- **Objektivat specifikojne** ate qe projekti i hulumtimit pritet te arrije (te beje, arrije, vleresoje, percaktoje, mate, etj.)
- Objektivat shprehen ne pjesen e **pergjitheshme** dhe **specifike**. Shpesh eshte pjesa me e shkurter e kerkimit, por eshte **pjesa qendrore** e projektit te kerkimit.

**Objektivi i pergjitheshem** – tregon qellimin kryesor te studimit. Ai buron direkt nga **formulimi i problemit te kerkimit**. Me e mira eshte **nje fjali!**

**Objektivat specifike** – nje numer ose nje liste nen-objektivash, secila prej te cilave ndikon ne arrijten e objektivit te pergjitheshem

# Hipotezat dhe objektivat

## Formulimi i objektivave

25

### Problemi:

Faktorët që ndikojnë në rritjen ekonomike mbeten **pamjaftueshmërisht të njohur**. Përmirsimi i kuptueshmërisë mbi këta faktorë do përmirsonte politikat e mbështetjes publike dhe aktorëve tjerë të interesuar.

### Objektivi i përgjithshëm

**Vleresimi** i ndikimit të faktoreve që determinojnë mundësinë e rritjes ekonomike.

### Objektivat specifike

- Vlersimi i ndikimit të rritjes së liberalizimit të tregut në mundësinë e rritjes ekonomike.
- Vlersimi i ndikimit të rritjes së investimeve të huaja në mundësinë e rritjes ekonomike.
- Vlersimi i ndikimit të harxhimeve të kapitalit publik në mundësinë e rritjes ekonomike.
- Vlersimi i ndikimit të uljes së indeksit të korrupsionit në mundësinë e rritjes ekonomike.

### Hipotezat (Nëse.....Atëherë)

- Rritja e liberalizimit të tregut do të ndikonte pozitivisht në rritjen ekonomike.
- Rritja e investimeve të huaja do të ndikonte pozitivisht në rritjen ekonomike.
- Rritja e investimeve të kapitalit do të ndikonte pozitivisht në rritjen ekonomike.
- Ulja e indeksit të korrupsionit do të ndikonte pozitivisht në rritjen ekonomike.



# Ju Faleminderit për vëmendje !

26

□ SUKSESE !

